



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr. _____, Prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, për publikim në
Buletin e Njoftimeve Publike)*

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Vlore sh.a

Adresa Lagja “Kushtrimi”, rruga “Arkobaleno” Vlore.

E-mail prokurimi@shrukv.al

Web-faqe info@ukv.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: Ref-96724-08-19-2026

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje karburanti”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 09100000-0 - Karburante

6. Fondi limit: 19,588,975 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH ose 210,476 (dyqind e dhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Euro pa Tvsh. (Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 10.08.2026, 1 euro = 93.07 All)

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 (gjashtë) muaj

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04.09.2026 ora 09:00

Në mbështetje të nenit 42, pika 6 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor argumenton shkurtimin e afatit të dorëzimit të ofertave në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, për procedurën me objekt **“Blerje Karburanti”**.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a. kryen një shërbim publik jetik dhe të pandërprerë, duke garantuar furnizimin me ujë të pijshëm dhe administrimin e sistemeve të ujësjetllës-kanalizimeve në të gjithë zonën e shërbimit. Për realizimin e këtyre funksioneve është i domosdoshëm përdorimi i

vazhdueshëm i mjeteve të transportit, mjeteve teknologjike, agregatëve dhe pajisjeve të tjera që operojnë me karburant.

Rezervat ekzistuese dhe kontrata në fuqi janë drejt përfundimit, ndërkohë që mungesa e furnizimit me karburant do të sillte vështirësi serioze në kryerjen e ndërhyrjeve emergjente për riparimin e avarive, monitorimin e objekteve, transportin e personelit teknik dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Kjo situatë krijon një nevojë urgjente për përfundimin sa më të shpejtë të procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës përkatëse. Në këto kushte, respektimi i afatit standard do të cenonte interesin publik dhe mbarëvajtjen e shërbimit të furnizimit me ujë, duke e bërë të pamundur për autoritetin kontraktor pritjen e afateve të zakonshme.

Gjithashtu, objekti i prokurimit është standard, i njohur gjerësisht në treg dhe nuk paraqet kompleksitet teknik që kërkon kohë të zgjatur për përgatitjen e ofertave. Operatorët ekonomikë që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të karburanteve disponojnë dokumentacionin dhe kapacitetet e nevojshme për përgatitjen e ofertave brenda afatit 15-ditor, pa cenuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të tyre.

Për sa më sipër, shkurtimi i afatit të dorëzimit të ofertave në 15 ditë vlerësohet i domosdoshëm, proporcional dhe në përputhje me nenin 42, pika 6 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR